

RELACION TEKNIK (PROJEKT ME PERSHKRIM)

Mirëmbajtje me performancë Librazhd - Steblevë, Urakë - Golik, Hotolisht - Frarë, Qukës – Qafë Ploçë Loti 1 (54.75 km) (Kontrata 8)

• Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërisë së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, apo me çdo kërkesë tjetër.

Në vecanti, ato përfshijnë detyrat menaxheriale dhe punimet fizike që lidhen me asetet dhe zërat që lidhen me rrugën:

- Asfaltimet
- Bankinat
- Sinjalistika dhe furnizimi pajisjet për sigurinë rrugore
- Ndriçimi (atje ku ekziston)
- Strukturat e drenazhimit
- Kontrolli i vegjetacionit
- Skarpatat (gërmimet dhe bankinat)
- Veprat e artit (muret mbajtës, pritës, tombinot e tjerë)
- Urat në veçanti
- Menaxhimi i trafikut
- Pastrimi i dherave
- Pastrimi i dëborës (nqs ka mirëmbajtje dimërore)

Shërbimet që kërkon Mirëmbajtja e një rruge klasifikohen në:

- Shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë në formën e sasisë së shprehur në një vlerë tavan mujore (kjo do jetë një sasi mujore e aplikueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së shprehur në çmim për kilometër për secilin muaj e shumëzuar me gjatësinë e rrugës dhe kohëzgjatjen e shërbimeve);
- Punimet Emergjente në formën e një preventivi tradicional.
- Punimet Periodike/Rehabilituese, në formën e sasisë së një vlere tavan, ndërsa tregohen sasi të punimeve të matëshme që do kryhen në mënyrë që rruga të arrijë Standardet e asaj performancë. Këto punime do të kryhen gjatë kohëzgjatjes së kontratës (të paktën një herë në vit), në sasinë dhe vendin që do të përcaktohet në bashkëpunim me punëdhënësin, kontraktorin dhe mbikqyrësin e punimeve.

Funksionet kryesore të bazave të mirëmbajtjes në përgjithësi, duhet të jenë si më poshtë:

1. Mbikqyrja e segmentit/seksionit rrugor në periudha të caktuara sipas niveleve të shërbimit
2. Vëzhgimi i faktorëve meteorologjikë
3. Ndihma e parë në rast aksidenti (në lidhje me elementët e rrugës dhe trafikut)
4. Mirëmbajtje në kushtet e dëshiruara të shtresave rrugore
5. Mirëmbajtja e hapësirave të parkimit, shërbimit, shenjave rrugore, sistemeve të ndriçimit, sinjalizimit të ardhshëm e telekomunikacionit.
6. Riparime dhe rindërtim pas aksidenteve rrugore
7. Riparime dhe rindërtim pas fatkeqësive natyrore
8. Operacionet e pastrimit të drenazheve, tombinove dhe objekteve të tjera (ura dhe vepra arti) që lidhen me largimin e ujrave nga sipërfaqja e rrugës
9. Të gjithë operacionet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e :
 - shenjave rrugore, pajisjeve të sigurisë (trafikndarëse, parapete) sistemit të ndriçimit (zëvendësim llampash, riparime të vogla përcjellësish etj).
 - mirëmbajtja, pastrimi dhe riparimi i urave (përfshirë edhe grasatimin sharnierave, bojatisjen e pjesëve metalike të tyre etj);

- riparimi lokal i dëmtimeve të trotuarit
- kujdesi për bimësinë
- aktiviteti në dimer për largimin e dëborës dhe akullit.

Punimet e mirëmbajtjes në kushtet dimërore, përfshijnë:

1. Punime paraprake para fillimit të kushteve të dimrit
2. Organizimi i vendodhjeve të depozitimit të materialeve
3. Masat mbrojtëse kundër ngricave në rrugë, në rast të temperaturave shumë të ulta
4. Pastrimi i dëborës nga karrexhata e rrugës dhe sinjalet e komunikacionit dhe shenjat
5. Shenjimi i anëve të karrexhatës
6. Sigurimi i funksionimit të drenazhimit nga karrexhata
7. Heqjen e automjeteve nga rruga
8. Instalimi i sinjaleve të vecanta të komunikacionit në rastet e rregjimit të trafikut të veçantë të mbylljes së rrugës.
9. Informimi i vazhdueshëm i publikut për gjëndjen e rrugës dhe rrjedhën e trafikut.

• Segmentet që mbulon kontrata

Nr. Rrugës	Nr. Rendor	Emërtimi i Rrugëve	Tipi rrugës	Gjatësia totale (km)	Gjerësia (m)
ska	1	Librazhd - Togëz	SHL	3.4	6
ska	2	Togëz - Zgosht	SMTW	9.6	8
ska	3	Zgosht - Steblevë	SMTW	19	8
ska	4	Steblevë - Klenjë	SMTW	4.8	8
ska	5	Urakë - Golik	SFL	8.6	5
ska	6	Hotolisht - Frarë	SMTW	6.2	4
ska	7	Qukës – Qafë Plloçë, Loti 1 (pa asfalt)	SFL	3.15	12.5
GJATËSIA KM KONTRATA 8				54.75	

Shënim: SFL – rrugë në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SHL – rrugë në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SMTW – rrugë në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

• Kusht i veçantë

Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj nqs do të përfshihen në investim (rikonstrukcion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

• Sinjalistika dhe siguria rrugore

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

• Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga

Librazhd – Steblevë

Ky aks rrugor ndahet në katër segmente si më poshtë:

Librazhd – Togëz

Ky është segmenti i parë rrugor që lidh Librazhdin me zonën e Steblevës dhe mandej Peshkopinë.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë me nevoja të pakta për riparime.

Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.
Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme, sinjalistika horizontale duhet vijëzime të reja .
Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.
Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.

Togëz – Zgosht


Ky është segmenti i dytë rrugor që lidh Librazhdin me zonën e Steblevës dhe mandej Peshkopinë.
Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.
Shtresat asfaltike janë pjesërisht në gjendje të mirë, ka nevojë për riveshje të pjesëshme.
Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.
Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme, ka nevojë për vendosje guardrails.
Rruga është në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.
Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.

Zgosht – Steblevë

Ky është segmenti i tretë rrugor që lidh Librazhdin me zonën e Steblevës dhe mandej Peshkopinë.
Është segment me një karrexhatë me gjerësi 8m, me dy kahe lëvizje, rrugë çakulli jo në gjendje të mirë dhe ka nevojë për shtresë çakulli.
Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.
Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.
Rruga është në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.
Niveli i kërkuar i shërbimit “minimum”.

Steblevë – Klenjë

Ky është segmenti i katërt rrugor që lidh Librazhdin me zonën e Steblevës dhe mandej Peshkopinë.
Është segment me një karrexhatë me gjerësi 4m, rrugë çakulli jo në gjendje të mirë dhe ka nevojë për shtresë çakulli.
Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për riformim dhe pastrim.
Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.
Rruga është në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.
Niveli i kërkuar i shërbimit “minimum”. Segmenti ka nevojë për rikonstruksion (investim) nga ARrSh.



Urakë – Golik


Ky segment rrugor është degëzim majtas i rrugës nr. 3, Elbasan – Q. Thanë
Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.
Shtresat asfaltike janë në gjendje pjesërisht të mirë me nevoja për riparime.
Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.
Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.
Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Hotolisht – Frarë

Ky segment rrugor është degëzim majtas i rrugës nr. 3, Elbasan – Q. Thanë.
Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.
Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë me nevoja të pakta për riparime.
Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.
Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.
Rruga është në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.
Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Qukës – Qafë Pllaçë Loti 1 (pa asfalt)

Ky segment rrugor është tërësisht i ri dhe degëzon në anën djathtë të rrugës Librazhd – Q. Thanë, në fshatin Qendër Qukës.

Është segment me një karrexhatë me gjerësi 12.5m.

Deri në rifillimin e investimit do të kryhen ndërhyrje të karakterit rutinë dhe në periudha të caktuara do të bëhen mbushje gropash ose profilim me stabilizant.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “minimum”.

